



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**RADIO TELEVISIONI SHQIPTAR
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE**

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më __. __. 2021

NJOFTIM PËR VENDE VAKANTE

Radio Televizioni Shqiptar në zbatim të Vendimit nr. 98/2016, “Për miratimin e statutit të Radio Televizionit Shqiptar (RTSH)”; kërkon të punësojë:

1. Zëvendës drejtor të Përgjithshëm;
2. Drejtues në Njësinë e Programeve;
3. Drejtues në Njësinë e Emisioneve Tematike dhe Lajmeve
4. Drejtues në Njësinë e Teknikës.

1. Kriteret e përzgjedhjes së Zëvendës drejtorit të Përgjithshëm të RTSH-së janë:

- a. të jetë shtetas shqiptar;
- b. të ketë kryer arsimin e lartë; kur arsimi i lartë është kryer jashtë vendit, diploma duhet të jetë e njohur paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave, sipas legjislacionit në fuqi;
- c. të ketë përvojë pune ose përvojë si drejtues i drejtpërdrejtë në median e shkruar ose audiovizive jo më pak se 5 vjet;
- d. të ketë aftësi drejtuese edhe ide të qarta për zhvillimin e një transmetuesi audioviziv;
- e. Të njoh shumë mirë legjislacionin dhe praktikën lidhur me median audiovizive.

2. Kriteret e përzgjedhjes së Drejtuesit të Njësisë së Programeve të RTSH-së janë:

- a. të jetë shtetas shqiptar;
- b. të ketë kryer arsimin e lartë (preferohet Universiteti i Arteve); kur arsimi i lartë është kryer jashtë vendit, diploma duhet të jetë e njohur paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave, sipas legjislacionit në fuqi;
- c. të ketë përvojë pune ose drejtuese të drejtpërdrejtë në median e shkruar ose audiovizive jo më pak se 5 vjet;
- d. të ketë aftësi drejtuese edhe ide të qarta për zhvillimin e një transmetuesi audioviziv si Autor programesh dhe Prodhuar i tyre.

3. Kriteret e përzgjedhjes së Drejtuesit të Njësisë së Emisioneve Tematike & Lajmeve të RTSH-së janë:

- a. të jetë shtetas shqiptar;
- b. të ketë kryer arsimin e lartë (preferohet dega gazetari); kur arsimi i lartë është kryer jashtë vendit, diploma duhet të jetë e njohur paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave, sipas legjislacionit në fuqi;
- c. të ketë përvojë pune ose përvojë si drejtues i drejtpërdrejtë në median e shkruar ose audiovizive jo më pak se 5 vjet;
- d. të kenë aftësi drejtuese edhe ide të qarta për zhvillimin e një transmetuesi audioviziv.

4. Kriteret e përzgjedhjes së Drejtuesit të Njësisë së Teknike të RTSH-së janë:

- a. të jetë shtetas shqiptar;
- b. të ketë kryer arsimin e lartë (preferohet dega e inxhinierisë elektronike); kur arsimi i lartë është kryer jashtë vendit, diploma duhet të jetë e njohur paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave, sipas legjislacionit në fuqi;
- c. të ketë përvojë pune ose përvojë si drejtues i drejtpërdrejtë në median e shkruar ose audiovizive jo më pak se 5 vjet;
- d. të kenë aftësi drejtuese edhe ide të qarta për zhvillimin e një transmetuesi audioviziv.

Sa më sipër, të interesuarit duhet të dorëzojnë:

- Letër interesi për pozicionin përkatës;
- Fotokopje të dokumentit të identifikimit (ID);
- "Curriculum vitae" (CV) në gjuhën shqipe;
- Platformën dhe strukturën programore e organizative për vendin drejtues ku kandidon;
- Diplomën e arsimit të lartë (të noterizuar);
- Formularin e vetëdeklarimit (https://www.drejtesia.gov.al/wp-content/uploads/2018/10/formulari-i-vetdeklarimit_gjendja-gjyqesore.pdf);
- Dokumente të tjera plotësuese si: referenca, dëshmi nga punët e mëparshme, etj..

Aplikimet bëhen pranë zyrës së Protokollit të RTSH-së, duke nisur nga data 15.12.2021 deri më 07.01.2022.

DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE